



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 310

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR AKREDITIMIN E VËZHguesve TË subjekteve ZGJEDHORE,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 6, pikat 1, 4 dhe 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, të vendimit nr. 23, datë 01.02.2023 “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit dhe Vendet e Numërimit të Votave, në zgjedhje”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Delegimin e kompetencës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, te Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 12.4.2023 Nr: 310
Ora: 12:00



“Për delegimin e kompetencës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”